

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Alprofit Consult” shpk**

Sot, më 07.03.2022, ne, themeluesit,

- a) Juljana Avdi, atësia Luan, shtetase shqiptare, me numër personal identifikimi I76227019R, e datëlindjes 27.12.1987, lindur në Ersekë dhe banuese në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- b) Andi Haxhillari, atësia Bajram, shtetas shqiptar, me numër personal identifikimi I41128113I, i datëlindjes 28.11.1984, lindur në Dunicë, Pogradec dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është **“Alprofit Consult” shpk**.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - a) Ofrimin e shërbimeve të konsulencës financiare; shërbime të këshillimit financiar, shërbime kontabiliteti, shërbime të administrimit të taksave dhe shërbime të tjera administrative dhe organizative.
 - b) Shërbime të regjistrimit të biznesit; shërbime të regjistrimit fillestar dhe ndryshime të tjera në regjistrin tregtar.
 - c) Shërbime të tjera profesionale; në fushën e trajnimit profesional, shërbime të rekrutimit të trajnimit të punonjësve dhe shërbime e veprimtari të tjera të ngjashme.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga e “Elbasanit”, Pallati Fratari, Tershana 2, Shkalla 1, Kati 6, Apartamenti 27, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 120,000 (Një qind e njëzet mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Juljana Avdi, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 60,000 (Gjashtëdhjetë mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues Andi Haxhillari, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 60,000 (Gjashtëdhjetë mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6
Administratori

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Juljana Avdi, atësia Luan, shtetase shqiptare, me numër personal identifikimi I76227019R, e datëlindjes 27.12.1987, lindur në Ersekë dhe banuese në Tiranë; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.


Neni 7
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

O R T A K Ë T
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Alprofit Consult” shpk


Juljana Avdi
(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)


Andi Haxhillari
(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

